



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr. akti 420/1739

Korce, me: 01.04.2019

S H K R E S E- percjellese


Bashkise Maliq

Lutemi vendoseni njerën nga kopjet e shpalljes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce dt.01.04.2019 për njoftimin e të paditurës Mandolina Sabriu (Lalaj) **per nxjerjen e urdherit per caktimin e séances gjyqësore**, që po u dergojmë në vendin tuaj të afishimit, e tjetrën dergojeni perseri në adresë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce me konfirmimin e afishimit të shpalljes.

GJYQTARE
ARIOLA KRISTO



- Arkiv
- Z. Tepelenë
Z.N.
05-04-2019





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr. akti 420/1739

Korce, me: 01.04.2019

Shpallje

“Per njoftimin e urdherit per caktimin e seances gjyqesore”

Ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korce, po gjykohet çështja civile me nr. Regj. Them. 420/1739 me pale ndergjyqese:

Padites: Ilia (Idri)Sabriu

E paditur: Mandolina Sabriu (Lalaj)

Objekti: Zgjidhje martesë etj.

Baza ligjore: Neni 132 dhe 146 i Kodit të Familjes

Gjykatës i rezulton se e paditura Mandolina Sabriu (Lalaj), banuese Maliq, Blloku nr.3, nuk ndodhet në banesë, por është larguar jashtë shtetit.

Fakti i mesipërmi që qenies së saj jashtë shtetit është konfirmuar nga shkresa e Bashkisë Maliq si dhe nga të dhënat e sistemit TIMS për të.

Ne këto kushte e në mbështetje të nenit 133/a, pika(b) e 133/b të Kodit të Procedurës Civile, gjykata ka vendosur njoftimin e të padituesit të mesipërmi me shpallje publike me afat 20 ditë, duke shpallur(afishuar) atë në ambientet e dukshme të gjykatës; në Bashkinë Maliq, në territorin e të cilit ajo ka pasur vendbanimin e fundit për largimin jashtë shtetit; në vendin ku ajo ka pasur vendbanimin e fundit për largimin jashtë shtetit, pra në Maliq, Blloku nr.3 (derën e shtëpisë) si dhe do të botohet në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjykatës.

Në seancën pajtimore të datës 01.04.2019, në kushtet kur nuk u realizua pajtimi e u percaktua natyra e mosmarrëveshjes e provat që do të paraqiten, gjykata në mbështetje të nenit 134, 135 të Kodit të Familjes e nenit 158/c të Kodit të Procedurës Civile, nxorri urdherin për caktimin e seances gjyqësore, me përmbajtje si më poshtë:

1. Caktimin e seances gjyqësore **ne datën 30.04.2019, ora 09.00**, gjykim i cili do të zhvillohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korce.
2. Në seance gjyqësore, do të paraqiten si prova nga paditesi:
 - Deshmimtari Ilir Kolonja, banues në Maliq
 - Certificate martesë
 - Certificate familjare

- 4 certifikata personale per dy palet ndergjyqese e per dy femijet e tyre.
- 3. Pyetjen e dy femijeve te mitur Florian Sabriu e Kejvi Sabriu nga gjykata ne séance gjyqesore ne prani te psikologes Marinela Postoli.
- 4. Kryerjen e relacionit te vleresimit psikologjik nga psikologia Marinela Postoli.

Ne kushtet kur seanca pajtimore dt.01.04.2019, eshte zhvilluar ne mungese te te paditues Mandolina Sabriu , gjykata ne mbeshtetje te nenit 158/c/1 i Kodit te Procedures Civile, ka vendosur njoftimin e urdherit te caktimit te séances gjyqesore te paditues ne mungese. Ne rrethanat kur e paditura ka qene jashte shtetit e njoftimi i saj per gjykim eshte bere me shpallje, edhe njoftimi i urdherit per caktimin e séances gjyqesore do te behet perseri me shpallje, afishuar per 20 dite ne vendet e mesiperme.

Me afishimin e kesaj shpallje vihet ne dijeni e paditura Mandolina Sabriu (Lalaj), per nxjerrjen e urdherit te gjykates dt.01.04.2019 per caktimin e séances gjyqesore e per permbajtjen e tij.

Kjo shpallje zevendeson njoftimin(komunikimin) e rregullt per te padituren Mandolina Sabriu (Lalaj) ne lidhje me urdherin e gjykates dt.01.04.2019 per caktimin e séances gjyqesore e per permbajtjen e tij.

**GJYQTARE
Ariola Kristo**



U afishua ne Bashkine Maliq ne dt _____.

Per Bashkine Maliq _____.

(emer, mbiemer, firme)